



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 4, datë 01. 03. 2012

**PËR**

**"KRIJIMIN E QENDRËS SOCIALE "SHTËPIA E PËRBASHKËT" DHE MIRATIMI I STRUKTURËS ORGANIZATIVE"**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3/II, gërma "c", nenit 32, gërma "ç", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 për "Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore", ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); nenit 5, shkronja "a" dhe "b" të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për "Kompetencat për caktimin e pagave të punës" (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 për "Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.566, datë 14.07.2010 për "Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.378, datë 12.08.1999 "Për kalimin e së drejtës të përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore" (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1547, datë 27.8.2009 për "Nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike, rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 10.11.2006 "Për ndryshimin e destinacionit të një pjese të Ndërmarrjes Metalike "Tirana" në Qendër Sociale "Shtëpia e Përbashkët" si dhe miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të këtij objekti pranë Bashkisë së Tiranës"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25, datë 28.12.2011 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2012", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**


1. Të miratojë krijimin e Qendrës Sociale "Shtëpia e Përbashkët" me vendndodhje Laparakë - Njësia Bashkiake nr.11.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të miratohet struktura organizative e Qendrës sipas organigramës ( bashkalidhur ), si dhe niveli i pagave për punonjësit sipas lidhjes nr. 9, (pjesë përbërëse të këtij vendimi).
3. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në këtë qendër ditore të përkujdesit shoqëror do të jetë jo më shumë se 150 lekë (njëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Efektet financiare të zbatimit të këtij vendimi do të fillojnë më 01.04.2012 dhe do të përballohen nga fondi i mbartur i vitit 2011, në shumën prej 9.000.000 (nëntë milion) lekë të cilat do të shpërndahen si më poshtë:
  - a. Nga Zëri 600 “Paga” 4 300 000 lekë.
  - b. Nga Zëri 601 “Sigurime Shoqërore” 700 000 lekë.
  - c. Nga Zëri 602 “Shpenzime Operative” 4 000 000 lekë.
5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

**Niazi KOSOVRASTI**

## ORGANIGRAMA E QENDRËS SOCIALE “SHTËPIA E PËRBASHKËT “ – LAPRAKË



**Lidhja Nr. 9**

### NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E QENDRES SOCIALE

Nr.	Funksioni	Paga Bazë	Shtesa për vjetërsi
1	Drejtor i qendres	62 000	1%
2	Financier	40 000	1%
3	Punonjës Social	40 000	1%
4	Psikolog	40 000	1%
5	Fizioterapist	40 000	1%
6	Operator Social	40 000	1%
7	Ndhimës kuzhinier	20 000	1%
8	Pastrues	20 000	1%
9	Roje	20 000	1%

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr. 9**, të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, deri në **25 vjet** dhe të llogaritet mbi **pagën bazë**.